

Tirane me 13.01.2021

**KONTRATE - THEMELIMI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
"ANAIS ANAIS" shpk**

Me anen e ketij akti themelimi, ortaku I vetem :

**2.Z.Radvist Ali Dima, i dtl. 27.4.1987, lindur ne Sofie Bullgari e banues  
ne Sofie , Ul Iskar 6 paisur me Pasaport bullgare me Nr Identifikimi Nr.  
8704279526**

Me cilesine e "ortakut themelues " me kerkuan redaktimin e ketij akti themelimi, nepemjet te cilit deklarojne se me vullnet të lire të plote e të sinqerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise ne Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregtare ", ne ligjin " Per Qendren Kombetare te Regjistrimit ", ne ate Doganor, Fiskal e Tatimor, krijojne shoqerine tregtare, me pergjegjesi të kufizuar, "ANAIS ANAIS" shpk.

**VENDOSIN**

Te Themelojne shoqerine me pergjegjesi te kufizuar , e cila do te kete emertimin e saj "ANAIS ANAIS " SH.P.K.

**Neni 1  
Emertimi i Shoqerise**

Shoqeria do te kete emrin e saj tregetar "ANAIS ANAIS " SH.P.K.

**Neni 2  
Forma juridike**

Shoqeria "ANAIS ANAIS" SH.P.K. do te kete formen juridike te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar.

Shoqeria eshte person juridik i themeluar sipas se drejtes shqiptare. Ajo zhvillon veprimtarine e vet ne perputhje me legjislacionin shqiptar ,dispozitat e statutit dhe te Aktit te Themelimit.

**Neni 3  
Vula e Shoqerise**

Shoqeria do te kete vulen e saj permbajtja e se ciles do te jete si vijon:

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**

**Shoqeria "ANAIS ANAIS " SH.P.K.**


Ne te gjitha aktet ose dokumentat qe do te nxjerre shoqeria, shenohet emri i plote i shoqerise ose i shkurtuar, vlera e kapitalit themeltar dhe administratori.

**Neni 4  
Selia e shoqerise**

Selia qendrore e shoqerise do te jete Tirane, ne adresen:

Rruga "Sami Frasheri", Pallati Frateri Kati 0, H1 Tirane.

Shoqeria ka te drejte qe me vendim te Asamblese se ortakeve te mund te hape dege. zyra, filiale ose perfaqesi te shoqerise ne qytete te tjera te Shqiperise dhe jashte saj.



**Neni 5**  
**Objekti i veprimtarise se shoqerise**

**Hapje dhe menaxhim te Bar-Kafe, Restorant, Hotel .**

**Tregetim dhe magazinim me shumice e pakice te te gjitha artikujve ushqimore dhe industriale, artikujve kozmetike, artikujve per higjenen e trupit, paisje te ndryshme etj.**

**Tregetim dhe magazinim te Produkte bujqesore dhe blegtorale, fruta perime, bime medicinale, etero vajore e mjeksore.**

**Transport mallrash brenda dhe jashte vendit.**

**Import-Eksport.**

**NENI 6**  
**KOHEZGJATJA**

Shoqeria do te kete kohezgjatje mbi 10 vjet.

**NENI 7**  
**KAPITALI THEMELTAR , KONTRIBUTET, PJESET E KAPITALIT**  
**THEMELTAR DHE TRANSFERIMI**

**NENI 8**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000,00 leke dhe ortaku zoteron:  
Radvist Dima vlera e kapitalit 100.000,00 , numuri pjeseve 1,00, pjesmarrja ne perqindje 100%.

**NENI 9**

**MARRJA E VENDIMEVE, ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI I SHOQERISE**

**ASAMBLEJA E ORTAKEVE**

Asambleja e ortakeve organizon, drejton dhe kontrollon gjithe aktivitetin e shoqerise.  
Ajo perballon se bashku humbjet e shoqerise deri me kufirin e vleres se kontributit te tij.

**NENI 10**

**DREJTIMI SHOQERISE**

Shoqeria do te administrohet nga ortaku **Z. Radvist Dima** , per 5 ( pese) vjet kohe, ne perputhje me statutin dhe dispozitat respektive te Ligjit .  
Rregullat per funksionimin dhe drejtimin e shoqerise jane percaktuara ne Statutin e shoqerise qe shoqeron kete Akt Themelimi.

Te gjitha mosmarreshjet me organet shtetore , personat juridike e fizike vendas e te huaj,do te zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Ky akt themelimi perpilohet ne kater kopje , duke patur secila kopje, fuqi te plote ligjore, nenshkruhet regullisht nga te tre ortaket, me vullnetin e tyre te lire dhe te plote.

**ORTAKU**

*Radvist Dima*  
*[Signature]*